

Integrimi me ContiPressureCheck™

Ulni kostot e përgjithshme të funksionimit duke kontrolluar presionin e gomave.

Frotcom është i integruar me sistemin e monitorimit të gomave ContiPressureCheck™ të Continental. Sistemi bën matje vazhdimisht të presionit dhe temperaturën e të gjitha gomave në automjetet tuaja, duke ju lejuar të kurseni karburant, të rrisni kilometrazhin dhe të zvogëloni rrezikun e prishjes së gomave.

Gomat e flotës suaj, me fjalë tjera mbështesin të gjitha aktivitetet e automjeteve tuaja. Nuk është çudi që kushtet në të cilat gomat funksionojnë kanë një ndikim kaq të madh në kosto dhe siguri.

Tani, me Frotcom, ju mund të ndiqni nga afër këto kushte, do të thotë duke kontrolluar presionin dhe temperaturën. Jo vetëm që zbuloni dhe madje parashikoni dështimet e gomave, por gjithashtu mund të përmirësoni kilometrazhin total të kaluar në secilën gomë, duke mbajtur presionin e gomave brenda intervalit të rekomanduar.



Si ndihmojmë ne

Pasi të lidhet me sistemin e monitorimit të gomave ContiPressureCheck™ të Continental me kuader/kontakt te hapur, Frotcom ju lejon të monitoroni presionin dhe temperaturën në secilën gomë individuale.

Ju mund të përcaktoni kufijtë e presionit dhe të temperaturës për çdo automjet. Nëse Frotcom zbulon një situatë jashtë kufijve, do të gjenerohet një alarm, i cili mund t'i dërgohet drejtuesit përkatës dhe kujtdo tjetër në organizatë apo kompani.

** Sipas Continental, ju mund të reduktoni në mënyrë aktive kostot e funksionimit deri në 1500 euro për automjet në vit. Kjo llogaritje bazohet në një kamion 4 x 2 me një gjysmërimorkio me tre boshte, që lëviz 140,000 km në vit (çmimi i supozuar i naftës: 1 €/L), dhe duke përfshirë një kosto të vlerësuar prej 700 euro, gjithashtu në vit, për një incident i prishjes së gomave.*

Për shkak se gomat e fryra më pak mund të çojnë në kosto të larta funksionimi*, të gjitha gomat duhet të kenë presionin e fryrjes në intervalin e rekomanduar. Megjithatë, monitorimi i presionit të gomave nuk ndodh gjithmonë aq shpesh sa duhet.

Duke monitoruar gomat tuaja në mënyrë të përhershme, edhe gjatë udhëtimit, ju do të ulni kostot e funksionimit dhe do të minimizoni rrezikun e dështimit të gomave.

Benefitet

Ulja e kostove operative

Duke vozitur me presionin e duhur të ajrit, ju ulni konsumin e karburantit dhe koston përkatëse.

Përmirësoni sigurinë dhe zvogëloni kohën e ndërprerjes së punës.

Monitorimi i përhershëm parandalon prishjet e lidhura me gomat që mund të çojnë në ndërprerje të automjeteve, vonesa në punë dhe më keq se kaq, në aksidente.

Zgjatni jetëgjatësinë e gomave

Duke i drejtuar gomat në kushtet e rekomanduara, ju rritni kilometrazhin për secilën gomë dhe ruani vlerën e shtresës së gomës dhe në këtë mënyrë, rimatshmërinë e saj.

Sjellje eko-miqësore

Duke udhëtuar me presionin e duhur të gomave, automjetet tuaja jo vetëm që ulin konsumin e karburantit dhe zvogëlojnë konsumin e gomave në përgjithësi, ato gjithashtu reduktojnë emetimet e CO2 dhe rrjedhimisht mbrojnë mjedisin.

Lironi drejtuesit/shoferët tuaj nga detyrat e tjera

Për shkak se monitorimi i presionit të gomave tani bëhet automatikisht, nuk keni nevojë që drejtuesit/shoferët tuaj të kontrollojnë shpesh gomat. Koha e tyre mund të shpenzohet më mirë në aktivitete të tjera.

Si punon

Integrimi i Frotcom me sistemin e monitorimit të gomave ContiPressureCheck™ të Continental përdor e mëposhtëm:

1. Sensorët e gomave

Çdo gomë është e pajisur me një sensor gomash me valë me bateri. Sensorët janë montuar në shtresën e brendshme të gomës, brenda një paketimi gome. Kur kontakt/kuadri është i hapur, sensorët matin vazhdimisht presionin dhe temperaturën e gomave.

2. Njësia qendrore e komunikimit

Të gjithë sensorët komunikojnë me vale/wifi me një njësi qendrore. Kjo njësi mbledh informacion nga të gjithë sensorët, në lidhje me presionin, temperaturën dhe statusin e baterisë.

3. Pajisja gjurmuese Frotcom

Pajisja gjurmuese e Frotcom shton të dhënat e mbledhura të gomave në të dhëna të tjera që dërgohen në kohë reale në qendrën e të dhënave të Frotcom (të dhënat GPS, CANBus, të dhënat, etj.)

4. Statusi i baterisë

Në rast se Frotcom zbulon se bateria e vendosur në një sensor është e ulët, ai do të gjenerojë alarmin përkatës, në mënyrë që sensori të mund të zëvendësohet.

5. Përpunimi i të dhënave

Të dhënat në lidhje me gomat përpunohen në qendrën e të dhënave të Frotcom dhe krahasohen me intervalet e përcaktuara. Nëse presioni ose temperatura bie jashtë atyre intervaleve, gjenerohen alarme. Frotcom gjithashtu mund të karakterizojë automatikisht rënien e presionit si rrjedhje e ngadaltë ose rrjedhje e shpejtë.

6. Marrja e një alarmi

Sinjalizimet u dërgohen drejtuesve, për shembull duke përdorur aplikacionin e shoferit - DriverApp në bord. Prandaj, drejtuesit mund të reagojnë në përputhje me rrethanat dhe ta korrigjojnë problemin në kohën e duhur.

7. Gjysmërimorkio

Sistemi është në gjendje të pranojë rastet kur kamionët (kokat e traktorit) janë të lidhur me gjysmërimorkio të pajisura me sensorë gomash. Ai do të njohë automatikisht gjysmërimorkionë e re dhe do të raportojë presionin dhe temperaturën e gomave të saj.


Karakteristikat kryesore

- Monitorimi automatik i kushteve të gomave: presioni dhe temperatura
- Alarmet u dërgohen shoferëve dhe njerëzve të tjerë në organizatë, në mënyrë që situatat të korrigjohen menjëherë
- Zbulimi i baterisë së ulët (në sensorë)
- Planime të shumta për modele të ndryshme automjetesh dhe kombinime kamionësh dhe gjysmërimorkiosh, deri në maksimum 24 goma. Është i përshtatshëm për traktorë, rimorkio, kombinime traktor/rimorkio, si dhe autobusë.
- Komunikimi me wifi nga sensorët në njësinë qendrore të komunikimit.

Karakteristika të tjera të ngjashme që mund të keni interesim

- Panel i avancuar
- Aplikacioni për shofer
- Analizat e sjelljes të vozitjes
- Trajnimi i shoferit
- Menaxhimi i karburantit

Vendosja e modelit SMPG në Frotcom



MENAXHIM
INTELEGJENT I FLOTËS
PËR KOMPANINË TUAJ.

WWW.FROT.COM.COM

FROTCOM[®]
INTELLIGENT FLEETS